

UDHËZIM
Nr. 179, datë 11.1.2017

**PËR DOKUMENTACIONIN E APLIKIMIT PËR LICENCË DHE PROCEDURAT E
INSPEKTIMIT, PEZULLIMIT DHE/OSE SHFUQIZIMIT TË LICENCËS PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENCISË SË UDHËTIMIT DHE OPERATORIT
TURISTIK**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të nenit 48 dhe 51 të ligjit nr. 93/2015 "Për turizmin", të nenit 16, pika 3 dhe nenit 19 të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulla të tjera nënligjore të përbashkëta të Këshillit të Ministrave",

UDHËZOJ:

KREU 1
DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT PËR LICENCË

1. Veprimtaria e agjencisë së udhëtimit do t'i nënshtrohet pajisjes me licencë, me kodin XIII.1.A "Agjenci udhëtimi", sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat, autorizimet dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar.

2. Për pajisjen me licencë për veprimtarinë e agjencisë së udhëtimit, personat fizikë ose juridikë duhet të paraqesin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) këto dokumente:

a) Diplomën universitare të paktën të ciklit të parë të studimeve në fushën e turizmit ose administrimit të biznesit të lëshuar nga universitete brenda ose jashtë Shqipërisë dhe/ose diplomë e lëshuar nga IATA në fushën e turizmit dhe/ose diplomën e shkollës së mesme profesionale për turizëm dhe/ose çdo certifikatë kualifikimi profesional në fushën e turizmit për drejtuesin teknik ose përfaqësuesin ligjor. Diplomat universitare të lëshuara nga universitete të huaja duhet të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Certifikatat e marra jashtë shtetit duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të legalizuara/apostiluara.

b) Kontrata e punës me drejtuesin teknik, nëse ky është i ndryshëm nga përfaqësuesi ligjor.

c) Certifikata e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për 5 vitet e fundit për përfaqësuesin ligjor të lëshuar jo më herët se 3 muajt e fundit. Për shtetasit e huaj, certifikata e gjendjes gjyqësore duhet të lëshohet nga organet përgjegjëse në shtetin ku ai ka jetuar për 5 vitet e fundit.

d) Certifikata e pronësisë dhe/ose kontratë qiraje dhe/ose kontratë huapërdorje që vërtetojnë zotërimin e një mjedisi pune jo më të vogël se 10 m²;

e) Vetëdeklarim për sipërfaqen e mjedisit të punës që përdoret për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit;

f) Vetëdeklarim për pajisjet e përshtatshme të punës.

3. Veprimtaria e operatorit turistik do t'i nënshtrohet pajisjes me licencë, me kodin XIII.1.B "Operator turistik", sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave "Për licencat, autorizimet dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", të ndryshuar.

4. Për pajisjen me licencë për veprimtarinë e operatorit turistik, personat fizikë ose juridikë duhet të paraqesin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) këto dokumente:

a) Diplomën universitare të ciklit të parë të studimeve në fushën e turizmit të lëshuar nga universitete

brenda ose jashtë Shqipërisë për drejtuesin teknik. Diplomat universitare të lëshuara nga universitete të huaja duhet të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

b) Diplomën universitare të ciklit të parë të studimeve në fushën e turizmit të lëshuar nga universitete brenda ose jashtë Shqipërisë për përfaqësuesin ligjor. Diplomat universitare të lëshuara nga universitete të huaja duhet të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

c) Kontrata e punës me drejtuesin teknik.

d) Certifikata e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për 5 vitet e fundit për përfaqësuesin ligjor të lëshuar jo më herët se 3 muajt e fundit. Për shtetasit e huaj, certifikata e gjendjes gjyqësore duhet të lëshohet nga organet përgjegjëse në shtetin ku ai ka jetuar për 5 vitet e fundit.

e) Dokument që vërteton eksperiencën e mëparshme në këtë fushë të drejtuesit teknik dhe përfaqësuesit ligjor (administratorit) do të pranohen:

- Kontratat e punës që specifikojnë pozicionin e punës në fushën e turizmit, dhe/ose

- Vërtetime pune të lëshuara nga punëdhënësi të mëparshëm, ku të specifikohet eksperiencia e punës në fushën e turizmit.

g) Certifikata e pronësisë dhe/ose kontratë qiraje dhe/ose kontratë huapërdorje që vërtetojnë zotërimin e një mjedisi pune jo më të vogël se 16 m²;

h) Vetëdeklarim për sipërfaqen e mjedisit të punës që përdoret për ushtrimin e veprimtarisë së agjencisë së udhëtimit;

Vetëdeklarim për pajisjet e përshtatshme të punës.

KREU II

INSPEKTIMET DHE PEZULLIMI DHE/OSE SHFUQIZIMI I LICENCËS

1. Kontrolli i zbatimit të kriterëve dhe kushteve të licencimit dhe ushtrimit të veprimtarisë nga agjencitë e udhëtimit dhe operatorët turistikë do të kryhet në përputhje me nenet 16 dhe 17 të ligjit 99/2015 “Për turizmin” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Licencat për veprimtaritë e agjencisë së udhëtimit dhe operatorit turistik pezullohen kur:

a) agjencia e udhëtimit ose operatori turistik nuk përmbush më kriteret e dhënies së licencës ose shkel detyrimet e përcaktuara në të;

b) agjencia e udhëtimit ose operatori turistik nuk përmbush kërkesat dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së tyre sipas akteve nënligjore në fuqi.

3. Konstatimi i mosplotësimit të kriterëve apo shkeljes së detyrimeve bëhet nga inspektorati përgjegjës për turizmin.

4. Pas konstatimit, inspektorati përgjegjës për turizmin pezullon licencën dhe njofton subjektin për përmbushjen e kriterëve apo detyrimeve, brenda një afati jo më shumë se 30 ditë.

5. Kur vendoset pezullimi i aktivitetit të subjektit, lajmërohet menjëherë ministria përgjegjëse për turizmin dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar, arsyet që e kanë çuar për të dhënë urdhrin e pezullimit dhe vendimi i pezullimit publikohet në regjistrin kombëtar të licencave, autorizimeve dhe lejeve.

6. Vendimi për pezullimin e licencës shfuqizohet nga inspektorati përgjegjës për turizmin kur verifikohet dhe vlerësohet se subjekti i ka plotësuar të gjitha detyrimet, sipas rastit.

7. Licenca e agjencisë së udhëtimit dhe operatorit turistik shfuqizohet nga inspektorati përgjegjës për turizmin:

a) kur rrethanat janë të tilla, që s’do të kishte kuptim apo mundësi për përmbushjen e kriterëve ose ndreqjen e shkeljes së detyrimeve nga subjekti brenda çdo afati të arsyeshëm pezullimi;

b) në rast të moszbatimit të detyrimeve brenda afatit të pezullimit të përcaktuar më sipër;

c) në rast të shkeljeve të rënda me faj nga subjekti dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtrim të interesit publik.

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Turizmit, Qendra Kombëtare e Biznesit dhe Inspektorati në fushën e turizmit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi